

# STATUTI I SHOQËRISË TREGTARE ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR

**GIDO Consulting SHPK**

## DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

NENI 1

EMERTIMI

Sot me date 13/09/2022 në bazë të ligjit nr. 9723 datë 03.05.2007 “Për QKB” të ligjit nr. 9901 datë 14.04.2008 “Për shoqëritë tregtare” me vullnetin e lirë te ortakut Z. **Gianluca Carradori** themelon shoqerinë **GIDO Consulting SHPK**. Me ortake Z. **Gianluca Carradori** .. Shoqëria e ka selinë në Shkoder Rruga “ Bujar Bishanaku”, Zona Kadastrale 8592 Numri i pasurise 1/007 –N10 , Shkoder dhe njihet me emrin **GIDO Consulting SHPK**.

Shoqëria **GIDO Consulting SHPK** ka të drejtë të celë filial degë e përfaqësi në qytete të tjera të Shqipërisë e jashtë saj, në përputhje me legjislacionin Shqiptar e ato të vendeve të tjera ku ato do të hapen.

Z **Gianluca Carradori** është administrator I shoqërisë për afat 5 vjecar.

NENI 2

Shoqëria **GIDO Consulting SHPK** e zhvillon veprimtarinë e saj në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe dispozita të parashikuara në dokumentet e krijimit të saj (statutit).

Shoqëria **GIDO Consulting SHPK** është person juridik.

NENI 3

Shoqëria **GIDO Consulting SHPK** krijohet për të ushtruar veprimtarinë e saj për një kohëzgjatje mbi 10 vjet.

Shoqëria **GIDO Consulting SHPK** mund të zgjatë afatin e veprimtarisë së saj ose mund ta mbylli aktivitetin e saj para këtij afati, sipas dispozitave që përcaktohen në këtë statut dhe sipas kritereve që përcaktohen nga legjislacioni në fuqi.

NENI 4

Shoqëria **GIDO Consulting SHPK** për detyrimet që do të lindin gjatë aktivitetit me të tretët, përgjigjet vetëm me pasurinë e saj. Ortakët e shoqërisë nuk përgjigjen për detyrimet e kësaj shoqërie me pasurinë e tyre që nuk është futur në kapitalin e shoqërisë. Pjesëmarrja me këtë




shoqëri nuk pengon ortakët të kenë pavarësi ligjore, organizative dhe të drejta pronësie jashtë kësaj shoqërie.

## NENI 5

### OBJEKTI I VEPRIMTARISË SË SHOQËRISË

Shoqëria **GIDO Consulting** SHPK do të ketë si objekt :

Shërbime konsulence ligjore; shërbime juridike dhe komerciale dixhitale; shërbime asistence dhe konsulence në ndërmjetësim dhe transaksione tregtare; - shërbimet e konsulencës dhe assistencës në proceset e ndërkombëtarizimit të biznesit; shërbimet e konsulencës në çështjet e pasurive të paluajtshme drejtpërdrejt ose me kontributin e palëve të treta, kompanive dhe/ose profesionistëve individualë të specializuar për këtë qëllim ose të regjistruar në regjistrat profesional; - shërbimet e konsulencës dhe organizimit të biznesit (menaxhimi, zhvillimi, marketingu, shpërndarja dhe logjistika) në mënyrë të drejtpërdrejtë forma ose me kontributin e palëve të treta, shoqërive dhe/ose profesionistëve individualë të specializuar për këtë qëllim ose të regjistruar në regjistrat profesional; shërbimet e konsulencës tekniko-ekonomike, kontabiliteti i kompanive, përpunimi i të dhënavë, kontrollet e kompanive, menaxhimi, kontrolli dhe auditimi i pasqyrave financiare, analiza financiare drejtpërdrejt ose me kontributin e palëve të treta, kompanive dhe/ose profesionistëve individualë të specializuar për këtë qëllim ose të regjistruar në regjistra profesionistë ; - ideim, planifikim biznesi - studime marketingu dhe kerkime tregu, marketing direkt, konsulence per shitblerje produktesh ne Shqiperi dhe jashte, krijimi i rrjeteve shperndarese dhe tregtare, sherbime sigurimesh dhe konsulence financiare ne forme direkte ose me kontributin e te treteve., shoqëritë dhe/ose profesionistët individualë të specializuar për këtë qëllim ose të regjistruar në regjistrat profesional; - shërbimet e përpunimit të të dhënavë për palët e treta drejtpërdrejt ose me kontributin e palëve të treta, kompanive dhe/ose profesionistëve individualë të specializuar për këtë qëllim ose të regjistruar në regjistrat profesional; - Shërbimet e organizimit dhe menaxhimit të burimeve njerëzore, madhësia e stafit, analiza, përshkrimi dhe dizajni i mikrostrukturës (punë, detyra,) dhe makrostrukturë (grafiku i organizatës, funksionet, përgjegjësitë), programet e verifikimit dhe reduktimi i kostos së punës, siguria në vendin e punës, biznesi vlerësimi i rrezikut dhe zbatimi dhe masat parandaluese përkatëse, kërkimi dhe përzgjedhja e personelit, kontabiliteti i personelit dhe përpunimi i të dhënavë, të kryera drejtpërdrejt ose me kontribute nga palë të treta, kompani dhe/ose profesionistë individualë të specializuar ose të regjistruar për këtë qëllim në regjistrat profesionalistë; - shërbimet e konsulencë përfutjen e cilësisë dhe përfertimin e produkteve dhe proceseve sipas rregulloreve kombëtare dhe komunitare në fuqi, planeve të cilësisë, informacionit dhe trajnimit mbi normat, standardet dhe teknikat për cilësinë të kryera drejtpërdrejt ose me kontributin e palëve të treta, kompanive dhe/ose profesionistë individualë të specializuar për këtë qëllim ose të regjistruar në regjistrat profesional; - shërbimet që synojnë realizueshmërinë e investimeve vendase dhe të huaja; qendra e thirrjeve, qendra kontaktuese, ofrimi i shërbimeve sekretare, vendbanimet, operimi me qira i hapësirave me orendi dhe pajisje të bashkangjitura; - zhvillimi, prodhimi dhe



tregtimi i platformave online, aplikacioneve celulare ose mjeteve të tjera të internetit në përgjithësi dhe shërbimeve inovative; aktivitetet e krijimit dhe publikimit të përmbajtjes editoriale për qëllime informative dhe komerciale, pronësore ose për llogari të palëve të treta, transversale në të gjithë sektorët e tregut, sipas nevojave të veta ose të palëve të treta; - krijimin dhe menaxhimin e e-commerce dhe start-ups; - krijimin dhe menaxhimin e faqeve të internetit, platformave të internetit dhe rrjeteve sociale për qëllime informative dhe komerciale; marketingu i hapësirës reklamuese edhe në platformat e internetit.

Për të arritur qëllimin e korporatës, shoqëria mund të kryejë të gjitha veprimet e nevojshme dhe në këtë mënyrë, ndër të tjera, të kryejë në përgjithësi transaksione të pasurive të paluajtshme, tregtare dhe industriale, financiare, hipotekore dhe të pasurive të paluajtshme, të përdorë çdo formë financimi me institucionet e kreditit. , bankat, kompanitë dhe individët, duke dhënë garancitë e duhura reale dhe personale, garanci reale në favor të palëve të treta, marrin përsipër aksione dhe interesa në shoqëri apo biznese të tjera, qoftë edhe të përkohshme, përfitojnë çdo përfitim fiskal dhe tatimor. , të koncesioneve të parashikuara me ligj të zakonshëm dhe të veçantë. Aktivitetet e blerjes, menaxhimit, administrimit, dhënieve me qira dhe shitjeve së pasurive të paluajtshme në Shqipëri dhe jashtë saj.

Shoqeria ka synim qe gjate studimit te tregut, te realizoje cdo lloj aktiviteti tregtar brenda kuadrit ligjor Shqiptar, i cili do te rrit perfitimet e Shoqerise.

## KREU II

### MARRËDHËNIET EKONOMIKE-FINANCIARE

#### NENI 6

#### KAPITALI THEMELTAR

Kapitali Themeltar I shoqërisë **GIDO Consulting SHPK** është **100.000** lekë dhe perbehet nga ‘1’ (një) kuote/Pjese

Ky kapital themeltar zotërohet 100% nga ortaku Z. **Gianluca Carradori** i shprehur ne para 100.000 leke.

Kapitali themeltar ose pjesë të caktuara të tij e janë të transferueshme si ndërmjet nga ortakëve ashtu edhe përkundrejt personave të tretë.

Transferimi I kapitalit ose pjesëve të tyre në favor të një personi të tretë bëhet gjithmonë me miratim të ortakëve dhe me akt notarial.

Në qoftë se njëri nga ortakët dëshiron të shesë kuotat e kapitalit të tij, duhet të respektojë të drejtën e parablerjes nga ortakët e tjerë, ose aprovin e tyre unanim për shitjen e pjesës së tij e një subjekti tjetër.

Vlerësimi I kapitalit themeltar në natyrë bëhet nga ortakët në një marrëveshje të vecantë ose një nga ekspertët kompetentë I caktuar nga ortakët.



## NENI 7

Zmadhimi ose zvogëlimi I kapitalit themeltar bëhet me vendim te asamblesë së ortakëve. Kapitali themeltar dhe transferimet e tij mbahen në një rregjistër të vecantë.

## NENI 8

Fitimet neto I realizuar nga aktiviteti I shoqërisë do të ndahet ndërmjet ortakëve në proporcion me kuotat e tyre takuese në kapitalin themeltar.

## NENI 9

Veprimitaria e shoqërisë realizohet në bazë të leverdisë ekonomike dhe pasqyrohet në bilancin e saj. Bilanci I aktivitetit të shoqërisë përgatitet në fund të vitit e duhet të dorëzohet Brenda muajit mars të vitit që vijon.

Bilanci I aktivitetit finansiar mund të bëhet nga vetë ortakët ose nga ekspertët e tyre. Por në të gjitha rastet, rezultatet e bilancit finansiar duhet ti bëhen të aprovoohen nga Asambleja e ortakëve Brenda muajve të mbylljes së vitit finansiar.

## NENI 10

Shoqëria krijon fondet e saj për zhvillimin e zgjerimin e aktivitetit.

Rezervat statuore te jene ne masen 5% te fitimit.

Përbërja e fondeve, burimet financiare të tyre, caktohen nga asambleja e ortakëve.

## NENI 11

Shoqëria i disponon plotësisht mjetet e saj financiare.

## KREU II

### TË DREJTAT DHE DETYRAT E ORTAKËVE

## NENI 12



Ortakët kanë të drejta kryesore të cilat ushtrohen nëpërmjet vendimeve të marra nga Asambleja e Ortakëve.

Të marrin pjesë ne administrimin e veprimitarive ekonomike-tregtare të shoqërisë, në përputhje me kontratën dhe statusin.

- Të kërkojnë dhe tu jepen të dhëna që kanë të bëjnë me gjendjen dhe veprimitarinë e shoqërisë si dhe të gjitha dokumentat e përpunuara nga shoqëria (bilanci, libra llogarie).
- Të bëjnë propozime dhe t'I paraqesin ato me shkrim para administratorit dhe Asamblesë së Shoqërisë.
- Të heqin dorë nga shoqëria në kushtet që përcaktohen në kontratë dhe në këtë statut.

#### NENI 13

Ortakët kanë këto detyra kryesore:

- Të depozitojnë kuotën e tyre ose kuotën suplementare në përputhje me kontratën dhe me vendimet e Asamblesë (për fondin rezervë).
- Të marrin pjesë në administrimin e shoqërisë nëpërmjet organeve të krijuara nga ata vetë.
- Të respektojnë detyrimet e caktuara nga Asambleja ose nga Administratori për realizimin e detyrave të shoqërisë.

#### KREU IV

#### ORGANIZIMI DHE DREJTIMI ADMINISTRATIV I SHOQËRISË

#### NENI 14

Organi më i lartë vendimor i shoqërisë është Asambleja e Ortakëve.

Në asamble marrin pjesë të gjithë ortakët me të drejtë vote sipas shumave të vëna në kapitalin themeltar të shoqërisë. Asambleja e ortakëve kryen këto funksione:

- Miraton Bilancin vjetor të shoqërisë.
- Vendos për shtimin, pakësimin ose transferimin e kapitalit themelor.
- Emëron dhe revokon Administratorin e shoqërisë.
- Emëron dhe revokon Ekspertin kontabël të Shoqërisë.
- Kryen modifikime në statusin pas ecurive të shoqërisë si dhe kontroll të shoqërisë.
- Vendos për mbylljen e aktivitetit të shoqërisë ose shndërrimin e saj me një tip tjetër shoqërie.



## NENI 15

Administratori I shoqërisë përfaqëson shoqërinë në marrëdhëniet me të tretët dhe ka të gjitha kompetencat për të vepruar në e më dhe për llogaritë e shoqërisë.

Shoqëria merr përsipër të gjitha përgjegjësitë që mund të vijë nga veprimet e kryera nga administratori. Administrator Z. **Gianluca Carradori** ka afat maksimal 5-vjet dhe afati është I detyrueshëm të parashikohet në aktet e shoqërisë.

## NENI 16

Administrator është përgjegjësi individualisht ose solidarisht ndaj shoqërisë ose ndaj personave të tretë, kur gjatë veprimeve të tyre shkelin ligjin, kontraten dhe statutin, si dhe shkeljet e kryera nga ai gjatë administrimit të shoqërisë. Marrëdhëniet e punës me punëtorët që do të punësohen pranë shoqërisë **GIDO Consulting** SHPK rregullohen me kontrata individuale, që do të lidhen me secilin prej tyre.

## KREU V

### MBYLLJA E AKTIVITETIT TË SHOQËRISË

## NENI 18

Veprimtaria e shoqërisë pushon me mbarimin e afatit të përcaktuar në kontratë në qoftë se ortakët me vullnetin e tyre të lirë nuk zgjatin këtë afat.

Shoqëria mund ti japë fund aktivitetit të saj dhe para afatit të përcaktuar në aktin e themelimit, me aprovimin e Asamblesë së Ortakëve.

## NENI 19

Kur shoqëria likujdohet plotësisht, Asambleja krijon komisionin e likujdimit në të cilin paraqet bilancin e likujdimit.

Pasuria e shoqërisë, pasi shlyhen detyrimet e shoqërisë, do të ndahet mes ortakëve në proporcion me kontributin e tyre në kapitalin themeltar.

Pasuria që është futur në shoqëri me të drejtë shfrytëzimi I kthehet pronar e vetë saj.

ORTAK I SHOQËRISË

Gianluca Carradori